



Operatori i Sistemit të Transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: OE “SINTEZA CO” sh.p.k., me NIPT NIPT K11324003F
Adresa: Rruga e “Barrikadave”, Qendra “Turdiu”, Apartamenti 2, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Mallra.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-16696-12-29-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tonera dhe aksesore për pajisje printimi multifunksionale”.

Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Data 31.12.2021, Nr. 192.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “COLOMBO” sh.p.k. me NIPT K36608208V
Vlera 2,176,000 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH.
2. OE “SINTEZA CO” sh.p.k. me NIPT K11324003F
Vlera 2,276,200 (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.
3. OE “INFOSOFT OFFICE” sh.p.k. me NIPT J62426002Q
Pa ofertë ekonomike.
4. OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k. me NIPT J72124001N
Pa ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “COLOMBO” sh.p.k., me NIPT K36608208V, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar, për zërat objekt prokurimi. Dokumentacioni i paraqitur nga ky OE, nuk përmban të dhëna për objektin e prokurimit, emrin e OE ofertues, suportin konkret që mund të marrë nga autorizuesi dhe mallrat objekt prokurimi.
- 2. OE “INFOSOFT OFFICE” sh.p.k., me NIPT J62426002Q, për arsye se:**
- Nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara në DST, përfshirë ofertën ekonomike dhe mostrat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit.
- 3. OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k., me NIPT J72124001N, për arsye se:**
- Nuk ka paraqitur Formularin e ofertës ekonomike dhe Listën e çmimeve të artikujve.
 - Nuk ka përmbushur pikën 1/b, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës, sipas detyrimit të përcaktuar në pikën 3.2 të Njoftimit të Kontratës, pjesë e Dokumenteve të Tenderit, në zbatim të nenit 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.
 - Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar, për të zërat objekt prokurimi.
 - Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga mostrat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “SINTEZA CO” sh.p.k., me NIPT K11324003F, Adresa: Rruga e “Barrikadave”, Qendra “Turdiu”, Apartamenti 2, Tiranë**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,276,200 (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

Skerdi Drenova